

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister
AGJENCIA E USHQIMIT DHE VETERINARISË
AGENCIJA ZA HRANU I VETERINARSTVO
FOOD AND VETERINARY AGENCY

Në mbështetje të nenit 9 paragrafi 9.1, 9.2 (b), 9.3 dhe 9.4 të Ligjit nr. 2004/21 Për Veterinarinë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës") nr. 18/01 nëntor 2007 dhe Listës së sëmundjeve infektive të kafshëve të dhëna në Programin e parë dhe të dytë, nenit 19 të Udhëzimit Administrativ MA-NR. 26/2007 Për luftimin dhe çrrënjosjen e sëmundjes së Tuberkulozit, Brucelozës dhe Leukozës tek gjedhet, nenit 8 të Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2008 Për parandalimin, kontrollin, luftimin dhe çrrënjosjen e sëmundjes së Plasjes-Anthrax-it, nenit 19 të Udhëzimit Administrativ Nr. 07/2008 Për luftimin dhe çrrënjosjen e sëmundjes së Brucelozës tek delet, dhitë dhe derrat, nenit 28 të Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2008 Për parandalimin, luftimin dhe çrrënjosjen e sëmundjeve infektive të bletëve, Vendimit Ref. Zv-M 438/06 datë 25. 10. 2006 Për procedurat për asgjësimin e shpendëve të prekura me sëmundjen "Gripi i Shpezëve – Avian Influenca" dhe kompensimin e fermerëve, nenit 8 paragrafi 3,4,5 dhe 6 të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) Nr. 15/2014 e në pajtim me nenin nenin 17 (paragrafi 5 dhe paragrafi 6) të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrie, Kryeshefi Ekzekutiv nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, më datën 27/10 /2014 nxjerrë dhe miraton:

RREGULLOREN Nr. 04/2014

Për procedurat për asgjësimin e kafshëve të gjalla për shkak të sëmundjeve infektive, lartësisë së çmimit për kompensimin e dëmit pronarëve të kafshëve dhe shitjes së produkteve me origjinë shtazore dhe bimore

I.- Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

Qëllimi

1. Me këtë Rregullore përcaktohen procedura për:
 - 1.1. Asgjësimin e kafshëve të gjalla të cilat asgjësohen për shkak të sëmundjeve infektive të përcaktuara sipas listës së sëmundjeve nga Programi i parë dhe Programi i dytë të Ligjit Nr. 2004/21 Për Veterinarinë,
 - 1.2. Lartësinë e çmimit për kompensimin e dëmit pronarëve të kafshëve të gjalla të cilat asgjësohen,
 - 1.3. Lartësinë e çmimit për kategoritë e kafshëve për shitje, por të cilat janë të lira nga sëmundjet dhe
 - 1.4. Lartësinë e çmimit për shitjen e produkteve me origjinë shtazore dhe bimore.

Neni 2

Therja e detyrueshme e kafshëve

Me qëllim të sigurimit të parandalimit, kontrollit dhe çrrënjësjes së sëmundjeve infektive të kafshëve të dhëna në Listës nga Programi i parë dhe i dytë të Ligjit Nr. 2004/21 Për Veterinarinë, kafshët e deklaruar si të infektuara do të thërrin nën kontrollin e veterinarit zyrtar, sa më shpejtë që të jetë e mundur.

Neni 3

Kompensimi i dëmit

1. Pronarit të cilit i janë therrë kafshët, përkatësisht i janë asgjësuar për shkak të sëmundjeve infektive, Autoriteti kompetent, përkatësisht Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë ia bënë kompensimin sipas legjislacionit pozitiv në fuqi për:

- 1.1. Kafshët e llojit të gjedhit të prekura nga: TBC, TSE, Bruceloza, Leukoza, Enzotike e Gjedisht, Afta Epizotike dhe Antraksi
- 1.2. Kafshët e llojit të deleve dhe dhive të prekura nga: Bruceloza, Antraksi, Gjuha e Kaltër, Afta epizotike dhe TBC,
- 1.3. Kafshët e llojit derra të prekura nga: Mortaja Klasike e Derrave.
- 1.4. Kafshët e llojit shpeze të prekura nga: Mortaja Atipike e Shpezëve dhe Gripi i Shpendëve.
- 1.5. Kafshët e llojit blete (koshere) të prekura nga: Mortaja Amerikane dhe Evropiane e Bletëve.

II.- Kompensimi i dëmit pronarit të kafshëve dhe vlera e kompensimit

Neni 4

Kompensimi i dëmit për kafshët e llojit të gjedhit

1. Pronarit të kafshës së llojit të gjedhit, i takon kompensimi i dëmit për kafshët e therura, përkatësisht asgjësuar, të deklaruar si të infektuara nga sëmundja.
2. Lartësia e kompensimit të dëmit për kafshët e llojit të gjedhit të prekura nga sëmundjet infektive nga neni 3 paragrafi 1.1. të kësaj Rregullore, bëhet sipas gjinisë dhe moshës, në përputhje me lartësinë e vlerës së kompensimit të përcaktuar me këtë Rregullore, sipas Tabelës Nr. 1.

Tabela Nr. 1

Meshkuj			Femra		
Mosha	Vlera e kompensimit ne euro		Mosha	Vlera e kompensimit ne euro	
	Raca Bushe	Racat Fisnike		Raca Bushe	Racat Fisnike
Deri ne moshën 3 muaj	150 €	200 €	Deri ne moshën 3 muaj	130 €	250 €
Nga 3 muaj deri ne 6 muaj	250 €	400 €	Nga 3 muaj deri në 6 muaj	200 €	400 €
Nga 6 muaj deri ne 9 muaj	400 €	600 €	Nga 6 muaj deri në 9 muaj	300 €	600 €
Nga 9 muaj deri ne 12 muaj	600 €	1000 €	Nga 9 muaj deri në 12 muaj	500 €	900 €
Nga 12 muaj deri ne 16 muaj	700 €	1200 €	Nga 12 muaj deri në 16 muaj	650 €	1000 €
Nga 16 muaj deri 20 muaj	900 €	1400 €	Nga 16 muaj deri 20 muaj	800 €	1500 €
			Nga 20 muaj deri 84 muaj lopët te cilat kanë pjelle	700 €	1300 €
			Nga 20 muaj deri 84 muaj lopët të cilat nuk kanë pjelle	700 €	1300 €

		Mbi 84 muaj	700 €	1300 €
--	--	-------------	-------	--------

Neni 5

Kompensimi i dëmit për kafshët e llojit të deleve dhe dhive

1. Pronarit të kafshës të llojit të deleve dhe dhive, i takon kompensimi i dëmit për kafshët e therura, përkatësisht asgjësuar, të deklaruar si të infektuar nga sëmundja
2. Lartësia e kompensimit të dëmit pronarit të kafshëve të llojit të deleve dhe dhive nga neni 3 paragrafi 1.2. të kësaj Rregullore bëhet në përputhje me lartësinë e vlerës së kompensimit të përcaktuar me këtë Rregullore, sipas moshës, në përputhje me Tabelën Nr. 2.

Tabela Nr.2.

Delet	Vlera e kompensimit
0-2 muaj	40 €
2-6 muaj	70 €
6-12 muaj (pjellja e parë)	120 €
Mbi 12 muaj	100 €
Dhitë	Vlera e kompensimit
0-2 muaj	40 €
2-6 muaj	70 €
6-12 muaj (pjellja e parë)	120 €
Mbi 12 muaj	100 €

Neni 6

Kompensimi i dëmit për kafshët e llojit derra

1. Pronarit të kafshës të llojit të derrit i takon kompensimi i dëmit për kafshët e therura, përkatësisht asgjësuar, të deklaruar si të infektuar nga sëmundja.
2. Lartësia e kompensimit të dëmit pronarit të kafshëve të llojit derra nga neni 3 paragrafi 1.3. të kësaj Rregullore bëhet në përputhje me lartësinë e vlerës së kompensimit të përcaktuar me këtë Rregullore, sipas moshës, në përputhje me Tabelën Nr. 3.

Tabela Nr. 3.

Derrat	Vlera e kompensimit
0-2 muaj	30 €
2-6 muaj	50 €
Mbi 6 muaj	100 €

Neni 7

Kompensimi i dëmit për kategorinë e shpezëve

1. Pronarit të llojit të shpezëve, i takon kompensimi i dëmit për shpezët e therura, përkatësisht asgjësuar, të deklaruar si të infektuar nga sëmundja.
2. Lartësia e kompensimit të dëmit pronarit të llojit të shpezëve nga neni 3 paragrafi 1.4. të kësaj Rregullore bëhet sipas moshës, në përputhje me lartësinë e vlerës së kompensimit të përcaktuar me këtë Rregullore, si që është paraqitur në Tabelën Nr. 4.

Tabela Nr. 4.

Kategoritë e Shpezëve	Çmimi ne euro
Zogjtë një ditor	0.35 €
Zogëza 18 javësh	1.00 €
Pula vojse	1.00 €
Pula te ekonomive familjare	2.00 €

Neni 8

Kompensimi i dëmit për Bletë

1. Pronarit të llojit të Bletëve, i takon kompensimi i dëmit bletët e asgjësuar, të deklaruar si të infektuar nga sëmundja.
2. Lartësia e kompensimit të dëmit pronarit të llojit bletë nga nenit 2 paragrafi 1.5. të kësaj Rregullore bëhet për koshere të bletëve, në përputhje me lartësinë e vlerës së kompensimit të përcaktuar me këtë Rregullore, si që është paraqitur në Tabelën Nr. 5.

Tabela nr. 5

Bletë (për koshere)	Çmimi në euro
1 koshere	100 €

Neni 9

Kompensimi për kuaj dhe gomar/Mushka

Kompensimit pronarëve të kafshëve kuaj dhe gomar/mushka bëhet sipas moshës, në përputhje me lartësinë e vlerës së kompensimit të përcaktuar me këtë Rregullore, si që është paraqitur në Tabelën Nr. 6.

Tabela nr. 6.

Kuaj	Çmimi në euro
0-3 muaj	50 €
3-12 muaj	80 €
Mbi 12muaj	60 €
Gomare/Mushk	Çmimi në euro
0-3 muaj	40 €
3-12 muaj	70 €
Mbi 12 muaj	50 €

III.- Çmimi i shitjes së produkteve me origjinë shtazore

Neni 10

Çmimi i mishit të gjedhit

Çmimi i mishit të gjedhit caktohet sipas kategorisë së mishit dhe moshës së gjedhit, në përputhje me Tabelën si në vijim:

Kategoria e mishit	çmimi në € për / Kg
1. Mish viçi me ashtë (mosha 2- 6 muaj)	3,00 €
2. Mish i gjedhëve të rritur (më shumë se 6 muaj)	2,50 €

Neni 11

Çmimi i mishit të deleve dhe dhive

Çmimi i mishit të deleve dhe dhive përcaktohet sipas kategorisë së mishit dhe moshës së deleve përkatësisht dhive, në përputhje me Tabelën në vijim.

Kategoria e mishit	çmimi në € për / Kg
1. Mish qengji dhe keci me ashtë (mosha 2- 6 muaj)	3,50 €
2. Mish i deleve dhe dhive të rritura (më shumë se 6 uaj)	3,00 €

Neni 12

Çmimi i mishit të derrit

Çmimi i mishit të derrit përcaktohet sipas kategorisë së mishit dhe moshës së derrit, në përputhje me Tabelën në vijim.

Kategoria e mishit	çmimi në € për / Kg
1. Mish gici (mosha 0-3 muaj)	1.80 €
2. Mish i derrave të rritur (më shumë se 3 muaj)	1.30 €

Neni 13

Çmimi i mishit të shpezëve (pulës)

Çmimi i mishit të shpezëve (mishi i pulës) përcaktohet sipas kategorisë së mishit dhe moshës së shpezëve , përkatësisht bojlerëve dhe pulave , në përputhje me Tabelën në vijim.

Kategoria e mishit	çmimi në € për / Kg
1. Mish i bojlerëve (35 – 45 ditë)	1.80 €
2. Mish i pulave (më shumë se 18 javë)	1.30 €

Neni 14

Kalkulimi me çmime

1. Çmimet sipas tabelave të çminimit të mishit nga neni 10, 11, 12, dhe 13 të Rregullores, janë të paraqitur si çmime minimale, përkatësisht çmime fillestare për shitjen e produkteve me origjinë shtazore me ankand publik dhe varësisht prej kërkesave, çmimet mund të ndryshojnë dhe të ngritën.

2. Për kalkulimin e çmimit janë marrë për bazë:

- 2.1.Senzitiviteti i ruajtjes se mishit, afati i shkurt i përdorimit si mish i freskët , kërkesat dhe kapacitetet e mjaftueshme frigoriferike, për transport dhe ruajtje te sasive te mëdha
- 2.2.Procedurat për përgatitjen e materialit të ankandit dhe aplikimi përkatësisht – pjesëmarrje në ankand .
- 2.3.Mish nga kafshët e konfiskuara sensibilizim i subjekteve qe te aplikojnë për blerje .

IV.- Burimet financiare

Neni 15

Mjetet financiare

Shuma e kompensimit për therje të detyrueshme të kafshëve të dyshuara ose të konfirmuara si të infektuara si dhe metodat për hedhjen dhe asgjësimin e sigurt të trupave të tyre sigurohet nga burimet financiare të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë.

Neni 16

Mënyra e kompensimit të dëmit

1. Kompensimi i dëmit përcaktohet duke përdorur vlerësimin individual sipas çmimit të tregut.
2. Shuma e kompensimit për kafshët të therura në mënyrë të detyrueshme për shkak të sëmundjeve infektive të cilat kompensohen sipas legjislacionit në fuqi, duke u bazuar në çmimin e tregut të kafshëve të gjalla për kategoritë e kafshëve si në nenin 3 të kësaj Rregullore dhe konstatimit të vlerës individuale.

Neni 17

Tabelat e vlerësimit

1. Tabelat e vlerësimeve si në nenin 4,5,6,7, 8 dhe 9 të kësaj Rregullore janë objektive dhe të bazuara në të dhëna e tregut. Çmimet për kategori të kafshëve përcaktohen duke shfrytëzuar të dhëna e çmimeve të shitjes për të njëjtën kategori të kafshëve, por të cilat janë të lira nga sëmundjet.
2. Të dhënat e shitjes se kafshëve grumbullohen çdo vit për të mbështetur tabelat e vlerësimit.
3. Vlerat në tabelat e kategorive të mësipërme janë siguruar nga informatat e grumbulluara të shitjeve të të gjitha kategorive të kafshëve, nëpër tregjet e kafshëve në Republikën e Kosovës.

V.- Analiza e të dhënave statistikore

Neni 18

Analiza e të dhënave

1. Për çdo vit kalendarik analizohen të dhënat statistikore të shitjeve për periudhën 12 mujore për të i mundësuar AUV-se të kalkuloj çmimin mesatar të tregut për secilën kategori të llojit të kafshëve.
2. Këto të dhëna statistikore ndihmojnë Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë në identifikimin e ndryshueshmërisë së çmimeve të shitjes për secilën kategori të kafshëve.

VI .- Asgjësimi i kafshëve për shkak të sëmundjeve infektive

Neni 19

Asgjësimi i kafshëve

1. Kompensimi i dëmit, për asgjësimin e kafshëve për shkak të sëmundjeve infektive, nga neni 3 i kësaj Rregullore, do të bëhet vetëm për kafshët që asgjësohen nga autoriteti kompetent, përkatësisht Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë dhe të njëjtat janë të identifikuara dhe regjistruara sipas legjislacionit në fuqi .
2. Vlerësimi i çmimit për kategoritë si më lartë vlen edhe në rastet e shitjes së kafshëve të gjalla me ankand publik , si çmimi fillestar gjatë zhvillimit të procedurës së ankandit publik.
3. Çmimi për kompensim sipas kësaj Rregullore vlen për periudhën një vjeçare
4. Afati rrjedhë nga data e nënshkrimit nga ana e Kryeshift Ekzekutive të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë.
5. Pas skadimit të periudhës prej një viti çmimet i nënshtrohen revidimit dhe harmonizimit me çmimet e tregut.

Neni 20

Pezullimi i shitjes së produkteve me origjinë shtazore


Inspektori kompetent i veterinarisë e pezullon shitjen e produkteve me origjinë shtazore, siç është mish i gjedhit, deleve, dhive dhe i derrit, nëse nuk është i sigurt dhe paraqet rrezik për shëndetin e njeriut dhe e kontrollon asgjësimin apo shfrytëzimin e produkteve përkatëse.

Neni 21

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hynë në fuqi pas nënshkrimit nga Kryeshifi Ekzekutiv i Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë.

Prishtinë, 27. 10. /2014

Kryeshifi Ekzekutiv

Dr. Valdet Gjinovci,